

Nr. _____ Prot

Durrës, më/..../.....

KONTRATË PUNE INDIVIDUALE

Kjo kontratë pune lidhet sot më dt. xx.xx.20xx në Fakultetin e Studimeve të Integruara me Praktikën eFASTIPö, Durrës me Autoritet Drejtues, Dekanin Doc. Vladimir Muka , i quajtur punëdhënës dhe Znj..... i quajtur më poshtë punëmarrës.

PARIME TË PËRGJITHSHME

Kontrata individuale e punës bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr.9741 datë 21.05.2007 për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 48,49 për punësimin e personelit akademik të ftuar me kontratë, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.827, datë 11.06.2008 dhe në Vendimin e Këshillit të Fakultetit Nr.6 datë 12.08.2009.

ENI 1 PËRSHKRIMI I PUNËS

I punësuari Z/Znj.pranon të punojë në personelin akademik të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën eFASTIPö, Durrës. Puna që do të kryejë: veprimtari të mësimdhënies, shërbime për zhvillim të institucionit, konsultim dhe këshillime për studentët.

ENI 2 KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Kjo kontratë lidhet për një periudhë kohe 10 ditore me marrëveshje të palëve kontraktuese. Zbatimi i kontratës fillon më dt. xx.xx.20xx dhe është e vlefshme deri më dt. Xx.xx.20xx. Që nga periudha që kjo marrëveshje hyn në fuqi, çdo marrëveshje tjetër e mëparshme është e pavlefshme.

ENI 3 KOHA NORMALE E PUNËS

Koha normale e punës do të jetë xx orë

ENI 4 PAGA

Pagesa e punëmarrësit do të bëhet si më poshtë:

1. Shpërblimi për orën akademike të punës.....; lek
2. Dieta ditore, sipas legjislacionit shqiptar
3. Shpenzime transporti, sipas legjislacionit shqiptar

ENI 5 LARGIMI NGA PUNA

Punëdhënësi mund të largojë nga puna punëmarrësin për këto arsye:

- 1- Paraqet paaftësi profesionale për punën e përshkruar në Kontratë.
- 2- Kur punëmarrësi nuk respekton urdhërat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të punëdhënësit.
- 3- Kur provohet se shpërdoron pasurinë e FASTIP.
- 4- Kur nuk zbaton rregulloren e brendshme të institucionit dhe shkel detyrimet kontratuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimet me shkrim të punëdhënësit, punëdhënësi me propozim të rektoratit ka të drejtën e prishjes së kontratës.
- 5- Kur provohet fajësia për ndonjë vepër penale në ngarkim të tij dhe dënohet me vendim të formës së prerë të Gjykatës, për më tepër se dy muaj.
- 6- Kur i ka lindur e drejta për pension të plotë pleqërie.
- 7- Kur nxjerr fakte të institucionit të destinuar të mbeten sekret.

ENI 6 PROCEDURA PËR ZGJIDHJEN E KONTRATËS

Në rast se njëra nga palët, punëdhënësi ose punëmarrësi, kërkon të zgjidhë kontratën e punës, atëherë ai duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim 2 javë, përpara ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Në rastet e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, në librezën e punës së punëmarrësit shënohet shkaku i largimit nga puna.

ENI 7 RESPEKTIMI I DETYRIMEVE

Palët kontraktuese duhet të zbatojnë me përpikmëri nenet e kontratës.

Kjo kontratë përpilohet në tre kopje nga të cilat dy i mban punëdhënësi dhe një punëmarrësi.

PALËT KONTRAKTUESE

PUNËDHËNËSI

PUNËMARRËSI

DEKANI

.....